



Nr-13/147  
Data; 28.02.2022  
Dragash

Në bazë të nenit 67, 68 dhe 69 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 5, pikës c. të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212, të Punës, Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr. 05/2015 Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit në Dragash, shpall:

## **KONKURS I MBRENDSHËM** **PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS**

Nr.	Institucioni	Pozita	Vendi i lirë
7	Shfmu "Ilmi Bahtijari" Blaç	Mësimdhënës i edukatës Muzikore për 12 orë	Vendi i lirë

### **I. Dokumentet e nevojshme:**

- *Formulari i aplikimit i plotësuar; ( merret në zyrën nr.4 në DKA)*
- *Rezymeja Personale (CV);*
- *Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) kopje;*
- *Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara tek noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh;*
- *Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT;*
- *Certifikatën nga Gjykata se nuk është nën hetime (origjinali)*
- *Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).*
- *Me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës, punëtori/ja është e detyruar të sjellë certifikatën e gjendjes shëndetësore.*

*Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.*

*Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).*

## **II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me aktet juridike të lartshënuara.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, kandidatët për të konkurruar për këto pozita duhet t'i plotësojnë këto kriteret e kualifikimit:

- Niveli master arsimor- Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

**Vëmendje !** Kanë të drejtë të aplikojnë vetëm kandidatët të cilët janë mësimdhënës në Institucionet arsimore në Dragash

### **Detyrat dhe përgjegjësitë për Mësimdhënësit**

- Të realizoj plan programin mësimor për vendin e punës , në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me Udhëzimet Kurikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjese aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës, si dhe
- Detyrat tjera që janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

**Vërejtje:** Sipas pikës 3 të nenit 11 për Kualifikimet e Mësimdhënësve, në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, qartësohet se: “Të gjithë të kualifikuarit në njësitet akademike që kanë përfunduar master arsimor 300 ECTS, sistemin katërvjeçar (profesor) dhe baçelor katërvjeçar 240 ECTS, kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin parauniversitar të paraparë me nenin 6 dhe 7 të këtij udhëzimi” Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim.

Në test me shkrim do të ftohen ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në ueb faqen e Komunës së Dragashit: <https://kk.rks-gov.net/dragash/> dhe përmes email-it (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit/es).

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë bëhet në varësi të lirimit real të vendit të punës në IEAA .

Në këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2021/2022.

## **Afati dhe mënyra e aplikimit**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në DKA zyra nr.4 përmes protokollit.

Dokumentet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga Komisioni.

Afati i aplikimit është **15 ditë**. Data e njoftimit në ueb faqen: <https://konkursi.rks-gov.net/> është prej datës 21/03/2022 deri me datën 19/04/2022, ndërsa data e aplikimit është nga data 20/04/2022 deri me datën 27/04/2022 Përveç ueb faqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në ueb-faqe zyrtare të Komunës:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/>

Dragash, 28.02.2022

Drejtori i DKA-së

**Selim KRYEZIU,prof**